ADEM ZAPLLUZHA

DAULLET E NJË NATE



Copyright@Adem Zaplluzha-2013

Konsilier editorial :

Halil Haxhosaj

Redaktor: **Baki Ymeri**

Lektor: **Veli Veliu**

Recensent: **Mazllum Baraliu**

Ballina: **Laura Rushani**

Redaktura teknike: **Botuesi**

*** * ***

Edhe ky libër del në dritë në kuadrin e Shoqatës së Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" - Kastriot

ISBN 978-9951-664-01-1

ADEM ZAPLLUZHA

DAULLET E NJË NATE

Shoqata e Shkrimtarëve
“Fahri Fazliu”
Kastriot, 2014

DAULLET E NETËVE KOSOVARE

Adem Zaplluzha duket si një gurrë e pashtershme e frymëzimeve lirike të mveshura në tesha të mëndafshta. Në vargjet e tij dremisin lulet e saksisë si një magjepsje e gërshetuar me pëshpëritje zogjsh që depërtojnë tejmatanë perdeve, duke të ftuar për një dremitje të ëmbël, ngase gjumi e ka kapluar lulishten e shtëpisë. Kosova me zogjtë, gështenjat, lulëkuqet dhe varret e dëshmorëve dremit. Në kuadrin e ciklit të parë, Sonte nuk dua të vdes, autori provon të luajë sonte fatin e zogjve. Ajo që ngjan me ajrin, duket si një ishull mes mjegullave. Ishulli i uritur dhe i etur si zogjtë e shkretëtirës. Dhe më tej:

"Rëra fluturon përtej mendimit/ Një kaktus i etur/ Pi ujë në shpirtin e rërës/ Dielli si në copë gacë e përskuqur/ I pjek zogjtë në fluturim e sipër. Netët kosovare zalisen në zërin e mullinjve, kur kjo dunë prej vezëve të breshkës, me gjasë paska mbetur, si një varr i vetmuar: "Një arkivol i hirtë/ Te një varr i panjohur/ I kreh flokët e thinjura të zjarrit", tejmatanë kufirit të kujtesës. Kur përmes pëlhurës së grisur të një anijeje, shpërthen kureshtja dhe guri i mullirit të duket si një blanë mbretërore, kur stina si syri i verbër i hënës, shikon tejpërtej galaktikave, rritjen e një shelgu të pikëlluar. Autori zgjohet "Përtej kujtesës/ Si nga një

ëndërr e trishtë”. Prej vezëve të thyera dalin çafkat, kurse qielli i mbuluar me pupla njerëzish, hingëllon si kali i sëmurë. Universi, imagjinata, tropet dhe figurat tjera stilistike nuk mungojnë, as atëherë kur Adem Zaplluzha, përtej parmakëve të dritares, sheh djersitjen e ajrit: “Te dhoma e pritjes/ Një shpend krahmadh/ Është ulur pranë kujtesës/ Dhe i ëndërron/ Ikjet e kota të stinëve”.

Shqiptarët, sipas tij, ishin me gjasa të parët, që e gjetën zjarrin, “Por mishin e pjekur e hëngri nata”. Dhe më tej: “Kur dëgjuam kushtrimin/ Tupanët veç ishin shurdhuar/ Nëpër mëhallë/ Bredhin ardhacakët e dehur/ Dhe i recitojnë do psalme të vjetra/ Në një gjuhë të huaj/ Që s’na përket neve”. Ne dënesëm një kohë të gjatë, thekson autori, dhe shton se me një ngashërim të padëgjuar deri atëherë, dëneste edhe kori i bretkosave: “Por vaji i jonë/ Më duket edhe sot/ Se i përngjante lutjeve të erës”. Vargjet e Adem Zaplluzhës duken si do këngë djepi në bibliotekën e sentimenteve letrare. Nën gurin e mullirit vërtiten shpresat dhe aspiratat, kur ti e përkujton zërin që e bluan romancën e ditëve të nesërme. Në vargjet e tij dremisin, madje, edhe shikimet ndaj yjeve, madje edhe ti, përmes kandilit që e përkund dritën e gjumit, kurse gjumi yt duket më i qartë se pa skajshmëria, në kohën kur: “Lëkura ime e grisur/ Shtatë herë u shit sot në treg/ Dhe herën e tetë/ U konvertua në hartën e Atdheut”.

Shqiptari i Kosovës nuk din të ndalet, sepse fjalët e tij kanë filluar t'i përngjajnë kristaleve të borës. Herë janë të ftohta si njerëzit, herë u përngjajnë eshtrave të elefantëve, e herë arkivoleve të kalbura: "Do dalim si gjarpri nga lëkura/ Do e grisim ëndrrën e posa nisur/ Te ky gur që nuk i përngjan as murit/ Do i mbjellim krahët e zogjve". Nuk kemi kohë për fluturime të reja, thekson autori: "Me mija vjet fluturuam/ Dhe asnjëherë nuk e mbërrimë cakun/ Sonte do të mendojmë pak më ndryshe/ Për itinerarin e kësaj udhe// Do ecim tejpërtej arsyes". Pse? Sepse nuk ka ndalje në këtë rrugë, dhe po qe se ndalemi, kurrë më, nuk do të mund ta prekim, ëndrrën tonë të posa nisur. Problemet e stilistikës letrare e angazhojnë kritikun të trajtojë krejt lëndën poetike, kurse ne e anashkalojmë këtë "porosi", duke analizuar vetëm poezitë e para, për të nxjerrë në pah të vërtetën, se kemi të bëjmë me një veteran të mirëfilltë të poezisë së sotme në Kosovë.

Më 30 korrik të këtij viti (2013), autori thekson me fjalë identike, se sonte është koha, të cilën e kemi pritur me mija vjet, dhe do të nisemi, atje poshtë te ledhnajat e historisë, ku na presin do punë posa të nisura. Dhe papritmas fanitet një re e dendur: "Më lëshoni", se "Sonte dua të dal/ Nga klishetë e së kaluarës/ Do hyj në labirintet e kësaj kohe/ Dhe si nëpër tregimet fantastike", do të kaloj në anën tjetër të lumit, në secilën degë të kësaj peme, do mbjellim nga një domethënie, kurse më

pastaj do të ecim, deri te sinorët e luadheve: “Koha është/ Për kositjen e barit të njomë// Nëse vonohemi/ Për udhëtimin deri te baladat/ Nëpër rrugët e metropoleve do i kërkojmë/ Pendlat e ndukura të zogjve/ Që mbetën peng i një tjetër kohe”. Vargje brilante që shëmbëllejnë me perëndimin e Ballkanit të çmendur, dhe një stinë të re, kur, herë shqepen e herë ngjiten hartat, kur një re e dendur, asnjëherë nuk i ndryshon itineraret. autorin e ngazëllen fillimi i mirësisë dhe mbarimi i ligësisë. Ai ëndërron për zogjtë e erës dhe paskajshmërinë e lumturisë. Sipas tij: “Këto gjëra që po i preki sot/ Më duket se i kam prekur/ Para disa shekujve/ kur vdisnin meteorët”.

Zëri i mullinjve të ujit dhe zëri i mullinjve të erës. Zëri i viktimave të luftës dhe zëri i ditës së nesërme. Dita e djeshme kur tundej edhe mali, kur si fije bari tundeshin rrapet, kur “Nga vegimet e një trishtimi/ Fluturoi një shpend gjigand “, kur deshën të qajnë nënat, kur nga një hënë e gjymtuar, si peri doli para lotëve, dhe u shndërrua në disa dallgë të papara. Përfytyrimi fanitet kur “Atë çast filloi të fryjë një furtunë/ Nëpër flokët e mjegullave/ Veç kishte rënë një borë e kuqe/ Mbase dimri/ Mund të prekej me dorë si hija”, kur më zë kotësia. Dhe papritmas, shqetsimin e zëvendëson optimizmi, kur filloj të mbjelli një farë të re, nga shpirti i erës, që i shtrydhi të gjitha trishtimet, dhe qeshi me gjelbërimin, deri sa pushojnë të reshurat: “Nuk kam më kohë për shitje/ As për të blerë s’kam lekë/

Tundem udhëve/ Si një varkë e humbur/ Dhe në shpirtin e pathyeshëm të detit/ U bie daulleve të kushtrimit".

Në ciklin e dytë, Daullet e një nate, defilojnë tituj poemash tjera briliante, si: Sonte do të ecim, Te flokët e erës, Vijnë edhe sërish kthehen, Përtej çdo mundësie, Në tregtarë ëndrrash, Nëpër rrugët e qytetit të ngrirë, Si disa gjallesa parahistorike, Rri varur skeleti i erës, Ata që u flijuan për ty, Dhe hija e një druri etj. Jashtë mureve të lagështisë është cikli i tretë. Si zgalemat e rrufeve, Një dhembje si kjo, Në kokën time rebele, Pastaj vjen heshtja, As atje e as këtu, Më shkruaj një letër, Në bëhemi zogj të egër, janë disa nga poezitë e këtij autori që shëmbëllejnë me një album historik të lirikës sonë kontemporane. Sipas filozofit rumun, Tudor Vianu, feja, filozofia dhe arti janë pjesë e specialiteteve. Bota moderne del në pah me dridhjen e parë të mendimit. Adem Zaplluzha meriton respektin e lexuesit për idetë dhe mendimet e tij në fushë të kulturës.

Baki Ymeri,
Bukuresht, shtator 2013

Sonte nuk dua të vdes

Cikli i parë

SI NJË VARR I VETMUAR

Do provoj të luaj sonte
Fatin e zogjve
Ajo që ngjan me ajrin
Duket si një ishull mes mjegullave
Ishulli i uritur dhe i etur
Si zogjtë e shkretëtirës

Rëra fluturon përtej mendimit
Një kaktus i etur
Pi ujë në shpirtin e rërës
Dielli si një copë gace e përskuqur
I pjek zogjtë në fluturim e sipër

Kjo dunë prej vezëve të breshkës
Me gjasa paska mbetur
Si një varr i vetmuar
Një arkivol i hirtë
Te një varr i panjohur
I kreh flokët e thinjura të zhurit

PËRTEJ KUJTESËS

Stina si syri i verbër
I hënës
Shikon tejpërtej galaktikave
Rritjen e një shelgu të pikëlluar

Përtej kujtesës
Si nga një ëndërr e trishtë
Prej vezëve të thyera
Dalin çafkat
Qielli i mbuluar me pupla njerëzish
Hingëllon si kali i sëmurë

Përtej parmakëve të dritares
Shoh djersitjen e ajrit
Te dhoma e pritjes
Një shpend krah madh
Është ulur pranë kujtesës
Dhe i ëndërron
Ikjet e kota të stinëve

Ne ishim me gjasa të parët
Që e gjetëm zjarrin
Por mishin e pjekur e hëngri nata

2.

Kur dëgjuam kushtrimin
Tupanët veç ishin shurdhuar
Nëpër mëhallë
Bredhin ardhacakët e dehur
Dhe i recitojnë do psalme të vjetra
Në një gjuhë të huaj
Që s'na përket neve

Ne dënesëm një kohë të gjatë
Me një ngashërim të padëgjuar
Deri atëherë
Dëneste edhe kori i bretkosave
Por vaji i jonë
Më duket edhe sot
Që i përngjante lutjeve të erës

LËKURA

Lëkura ime e grisur
Shtatë herë u shit sot në treg
Dhe herën e tetë
U konvertua në hartën e atdheut

POR NE DO ECIM

Sonte fjalët kanë filluar
T'i përngjajnë kristaleve të borës
Janë të ftohta si njerëzit
Herë u përngjajnë eshtrave të elefantëve
E herë arkivoleve të kalbura

Do dalim si gjarpri nga lëkura
Do e grisim ëndrrën e posa të nisur
Te ky gur që nuk i përngjan as murit
Do i mbjellim krahët e zogjve

Nuk kemi kohë për fluturime të reja
Me mija vjet fluturuam
Dhe asnjëherë nuk e mbërrimë cakun
Sonte do të mendojmë pak më ndryshe
Për itinerarin e kësaj udhe

Do ecim tejpërtej arsyes
Nuk ka ndalje në këtë rrugë
Poqë se ndalemi
Kurrë më
Nuk do të mund ta prekim
Ëndrrën tonë të posa nisur

Sonte është koha
Të cilën e kemi pritur me mija vjet
Dhe do të nisemi
Atje poshtë te ledhnajat e historisë
Na presin
Do punë posa të nisura

Prishtinë, 30 korrik 2013

NJË RE E DENDUR

Më lëshoni
Sonte dua të dal
Nga klishetë e së kaluarës
Do hy në labirintet e kësaj kohe
Dhe si nëpër tregimet fantastike
Të kaloj në anën tjetër të lumit

Në secilën degë të kësaj peme
Do mbjellim nga një domethënie
Më pastaj të ecim
Deri te sinorët e luadheve
Koha është
Për kositjen e barit të njomë

Nëse vonohemi
Për udhëtimin deri te baladat
Nëpër rrugët e metropoleve do i kërkojmë
Pendlat e ndukura të zogjve
Që mbetën peng i një kohe tjetër

këtu sa ora ndryshojnë stinët
Në lëkurën e Ballkanit të çmendur
Herë shqepen
E herë ngjiten hartat
Një re e dendur
Asnjëherë nuk i ndryshon itineraret

NJË HËNË E GJYMTUAR

Këto gjëra që po i preki sot
Më duket se i kam prekur
Para disa shekujve
Kur vdisnin meteorët

Mu te kjo hije e përhitur
I kam prerë thonjtë
Për t'i ushqyer zogjtë e erës
Në nofullat e ujkut uria ishte e madhe

Më kujtohet kur frynte shakullina
Tundej edhe mali
Si fije bari tundeshin rrapet
Nga vegimet e një trishtimi
Fluturoi një shpend gjigand

Kur deshën të qajnë nënat
Një hënë e gjymtuar
Si peri doli para lotëve
Dhe u shndërrua në disa dallgë të papara

Atë çast filloi të fryj një furtunë
Nëpër flokët e mjegullave
Veç kishte rënë një borë e kuqe
Mbase dimri
Mund të prekej me dorë si hija

KUR MË ZË KOTËSIA

Kur më zë kotësia
Filloj të mbjelli një farë të re
Nga shpirti i erës
I shtrydhi të gjitha trishtimet
Dh qeshi me gjelbërimin
Deri sa pushojnë të reshurat

Nuk kam më kohë për shitje
As për të blerë s'kam lek
Tundem udhëve
Si një varkë e humbur
Dhe në shpirtin e pathyeshëm të detit
U bie daulleve të kushtrimit

Kur s'kam se çfarë të bëj
Me duart e mia të tejdukshme
Ia fali Lumëbardhit
Tërë gjumin e erës me makthe
Le të udhëtoj deri te ëndrra e Jonit
Me ujin e kristaltë të shirave

Dhe kur më zë kotësia
Ulem në grushtet e shkumës
I skicoj të gjitha hartat e atdheut
Pastaj si një eremit i moshuar
Zë një vend nën blirin e lagjes
Dhe bisedoj
Me zogjtë e ikur të vendlindjes

PO VDES NJË MERIMANGË

Kjo stinë e acartë
Fshehurazi paska hyrë
Në ishullin e dhembjes
Dhe nuk ka të sosur kjo gjëmë

Po ikin zogjtë përtej kujtesës
Ky dimër i vetmuar
Po i përngjan flokëve të thinjura të erës
Po i përngjan
Trishtimit të jetës

Një njeri mbështetur te kukëzat
Ua qan hallin zogjve
Në këtë det të skamjes
Fluturimet nuk paskan të ndalur

Një fanar i vetmuar
I paska kyçur të gjitha dritat e ujit
Në rrjetin e shkumës së bardhë
Po vdes një merimangë

Hënëzat në një valle mortore
Vajtojnë si nuset
Diku në bregun e kundërt të jetës
Dëgjohet vaji i trishtuar i një gërnete

NJË ULËRIMË PREJ BISHE

Mos ,mos të lutem
Mos më kundro
Nga fushëveprimi i urrejtjes
Kjo mollë e papjekur
Është shkundur kaherë
Nga degët e thyera të kujtesës

Një pamje surrealiste
Paska lëshuar rrënjë
Në kujtesën e arkivolit

Shirat nuk zbritën mbrëmë
Si çdo herë
Nga shpirtrat e mjegullave
Fluturuan do zogj të verdhë

Më kujtohet
Fare mirë më kujtohet
Kur qante një çyçe mali
Mbi një trëndafil të zi

I tërë lisi i shkundi gjethet
Sa që u zhveshën degët
Si në teatrin antik
i dëgjuam piskamat e fëmijërisë

Dikur vonë
Kur një hije e zezë
I lëshoi perdet nëpër teatrot antike
U dëgjuan mjaullimat e maceve të egra
Mjaullinte skena prej dërrasave
Një ulërimë prej bishe
Ia prishi gjumin
E qytetit të përhitur

NJË VARKË E MOÇME

Si një hije e tejpashme
Doli në syprinën e njelmët
Një varkë e moçme
Pas saj
Dolën edhe hënëzat dhe kafshuan hënën

Ne ishim diku në fund të përrallës
Ndoshta edhe nuk dihej
Athua ishte fundi
Ose fillimi i një tregimit të pasosur
Por ishte diçka e paqartë
Që i përngjante kashtës nga legjenda

Më thanë se nëse mbërri në fund
Aty do t'i gjej
Fillimet e këputura të mjegullave
Në rrjetin e merimangës së zezë
Fle një tregim i dyshimtë

Eca edhe disa vite të verbëta
Asnjëherë nuk ngurova
T'i preki plagët e Gjergjit
Nga patërshana e trishtimit
Pikonte dhembja e një shekulli

LEHIN EDHE YJET

Isha vetë
Pas meje vinte nata
Dhe trokitjet e dyerve të hapura
kurrsesi të ndaleshin

Një qen nuk i ndal të lehurat
Lehin edhe yjet
Dy zogj prej kashte
E mëkojnë hënën e sëmurë

Isha fillikat me sterrën
Ishte edhe një hije e thyer
Vetëm errësira
Kërkonte dritën mes gishtave të natës

Askush nuk këndonte
Ama as nuk qante si era
Vetëm meteorët endacak
Mund të këndonin serenatë yjeve

KJO NATË

Me gjasa mbrëmë ishte nata e zogjve
Ne deshëm të këndojmë
Por pas nesh si një kor çafkash
Kënduan arkivolet

Një psalm posa kishte zënë vend
Te një dunë prej eshtrave
Në varrim përballë rrugës
Dëneste një qemane

Pak fjalë shumë pak folën
Zogjtë në ikje
Mbase nata ishte e gjatë
Nga majat e patërshanave
Pikonte një gjak i gjelbër

Pak shumë pak patëm kohë
T'i numërojmë plagët e hijeve
Kjo natë
Mos i përngjaftë asnjë nate
Dhe mos ardhtë më asnjëherë
Me kaq trishtim
Në mesin tonë

SI NJË HUKAMË DETI

Thua se jam njeri prej xhami
Të gjithë shikojnë nëpërmjet meje
Me sy të mbyllur
Parakalon një tregim sapo i nisur

Edhe kjo stinë e mrrolur
I ka shtri krahët mbi përparësen e shirave
Jashtë kësaj dhome qorre
Përmendësh këndohen psalmet

Një eremit me gjasa
I paska humbur librat e shenjtë
Nëpër faltoret e qytetit të Lumëbardhit
Kanë filluar të vdesin kambanat

Si një hukamë deti
Një gjëmë del nga shpirtngushtësia e tokës
Vullkani i vdekur pështynë zjarr
Si në ferr po digjen gurtë e atdheut

Prishtinë, 31 korrik 2013

NË LOTIN E THYER TË MËNGJESIT

Pikojnë dhe s'dinë të ndalen
Të reshurat
Ky shi hibrid si ushejza
Depërton në gjakun e njeriut
Dhe mpikset në mallin e mërgimtarit

Diku si nëpër legjenda
Po mbinë një përrallë e trishtuar
Njerëzit kanë filluar t'i mbjellin flokët
Në rrashtën e një guri
Po çelin manaferrat do lule molle

Nuk patëm kohë të ndalemi të moli
Anijet e ankoruara kishin ikur larg
Një mbret në vend se të abdikoj
E mbolli kurorën si lulen

Ne atë ditë nuk patëm se çfarë të bëjmë
I shkulëm zambakët nga syri i gurit
Dhe pimë ujë lajthie
Në lotin e thyer të mëngjesit
Sërish u ankoruan anijet e peshkatarëve

NËNA IME MOJ NËNË E MIRË

Askund nuk i shihet fundi
I kësaj nate
Nëna ime askund
Ti ishe ose s'ishe pranë nesh
Kur ne përjetuam tronditjen e shpirtit

Ku i lëmë duart e trishtuara të shiut
Atë natë nuk kishin të sosur dhembjet
Një tren i çmendur
Kalonte nëpër kalldrëmin e kujtesës

Ne mbetëm të shtangur
Si një kallam i papjekur
Përkundej era n'horizontin e përflakur
Atdheu im ishte në udhëtim e sipër
Mbi një tren shpirtrash
Shkuleshin si bari gjymtyrët e një stine

Thonë se në Mars fillojnë të dalin gjethet
Por këtu në fushat tona
Kjo stinë vjen lakuriqe si e lindur nga nëna
Vjen dhe na i sjellë telashet
Që as gurtë e stralltë s'mund t'i durojnë

Nëna ime e bukura e dheut
Më thuaj çfarë të bëjë
Cilën këngë ta këndoj sonte
Kur deri në pafundësi
Po dhemb shpirti i gurit

Nëna ime moj nënë e mirë
Sa krenare
Po aq edhe e pikëlluar
Më thuaj se çfarë të bëjë sonte

MIKU IM

Miku im
Cili do qofsh ti
Kaloje urën e pikëllimit
Nëse dëshiron
Të takohesh me pemën
Që rritet dhe shkulet në kujtesë

Kur të mbërrish në fund të udhës
Pusho pak
Nën hijen e degëve paganë
Dhe pastaj sërish mos u ndalë
Cili do qofsh ti
Ec deri te uji kryengritës

Vetëm një gllënjkë
S'të duhet më shumë
Për ta mësuar mjeshtërinë
E poçarit të verbër

I cili nga një copë deltine
Mundohet të krijoj një sy
Të bëjë një tokë për të gjithë njerëzit
Dhe një shpirt që merr frymë
Te një kokë njeriu

DY HERË NGA NJË E GJYSMË

Mbase sërish u kthyem nga Ferri
Asgjë nuk ishte afër meje
Në vetmi zgërdhihej
Një kovë e vjetër
E ndryshkur nga urinimi

Dy herë nga një e gjysmë
Kishte errësirë në atë vetmi
Mes lagështisë së paparë të mureve
Si kërthi dëneste një gozhdë

Ngjante që ndonjëherë
Të kem mysafir të paftuar
Vinte shpesh në vizitë një zog
Me një zarf të kaltër
Dhe m'i sillte letrat e nënës

Pos germave me ngjyrë menekshe
Nuk kisha se çfarë të preki
Këtu në këtë dhomë të lagshtë
Mund të preken vetëm ëndrrat

Zogu në dritare
Dhe një kovë urinimi në dysheme
Sa shumë i përngjajnë
Njëri tjetrit
Sa shumë

Kur kësaj jete të një burgosuri
I vjen era shurrë njeriu
Shurrë trishtimi
I këmishës së mykur të burgut

MË LËRË MË REHAT

Mos më mashtro
Ti tani je në brigjet e Adriatikut
Kurse unë rri këtu i vetmuar
Dhe si perënditë pagan
I numërojë këputjet e meteorëve

Mos të lutem mos i shpalos
Epshet e njelmësisë
Në mua janë fundosur të gjitha anijet
E mbretërve të pafat
Mbrëmë abdikova për të tretën herë

Si mund të jesh kaq e ngurtë
Ti po i përngjan cirqeve
Këndon por nuk të dëgjohet kënga
Me çfarë shkulmë malli
Mund t'i shëroj këto dhembje që s'bëzajnë

Mos të lutem mos m'i ngacmo ëndrrat
Nuk di se kujt do i përngjaja
Nëse m'i merr vegimet
Më lërë më rehat
Unë kam shumë probleme
Me vetveten time në këtë birucë

KJO KOHË

Nuk është koha
As t'i hapim e as t'i mbyllim
Portat e ëndrrave
Ky shi i kuq
Çmendurisht po bie të manat e qytetit

Pa ëndrra nuk mund të jetohet
Vetë ekzistenca
I përngjan një vegimi të trishtë
Dita ecën para nesh
Deri te bigëzimet e lumenjve

Një fjalë e lindur para ose pas ëndrrës
Ka po aq peshë
Sa gjumi i bletës mbi një gjeth prej mali
Një lule bore
Paska çelur zogj të bardhë
Në syrin e verdhë të ëndrrës

Nuk është koha të rrimë
Me dritare të mbyllura
Ëndrrat edhe ashtu nuk i njohin kufijtë
Kjo kohë si me dritare të hapura
Po ashtu edhe të mbyllura
Është vetëm një ëndërr e keqe

NUK DI A ËSHTË DIMËR

Nuk di a është dimër
Ose verë
Ky diell i ngrirë
Pikon vrer

Sytë në qiell
Te një hënë e kristaltë
Yjet po ma grimcojnë lëkurën
Si me një daltë

Një faqe e grisur
Arnon mollëzën e akullt
Kjo erë e krisur
Te pemët e çmendura i shkund stinët

Nuk di a është dimër
Ose një stinë meleze
Por mendja e jonë
Po ndryshon me shumë naze

KY SHPIRTI IM PAGAN

Sonte nuk dua të vdes
Le të ik ku të do
Ky shpirt i im pagan
Le të ikë
Si shpirtrat e zogjve
Ama unë s'dua ë vdes sonte

Dua të fluturoj
Ashti siç fluturojnë zgalemat
Sonte nuk ka vdekje
Mes këtyre portokajve
Dhe diellit alegorik

Më beso çfarë të them
Që nesër në mëngjes unë do kthehem
Me zërin
Dhe hukamën e shpirtit të frymës

Po të them
Se nuk ka vdekje sonte
Prej një shpirti pagan do të dal
Dhe do të fundosem
Në shpirtra zogjsh

Sonte dhe asnjëherë
Nuk do vdesin njerëzit
Ndryshimi i kësaj forme të ngurtë
I tejkalon
Të gjitha parashikimet e profetëve

Daullet e një nate

Cikli i dytë

SONTE DO TË ECIM

Këto vija konike
Po i përngjajnë emrit tim
Që nuk lakohet në rrasa
Dhe qeshin me shiun
Deri sa ngufaten ullukët me trishtim

Sonte do të ecim
Deri te fundi i baladës
Kur takohemi me bigëzimet e shikimeve
Do i përngjajmë bregut të lumit

Një grusht algash të verdha
Po i këndojnë psalmet e së dielës
Një shi rrebesh është nisur nga majat
Dhe nuk paska të ndalur

Do ulemi në këtë çast
Te shelgjishtet e djegura
Dhe do i pjekim mollët e shkundura
Për festën e madhe të Pashkëve

TE FLOKËT E ERËS

Kur kam uri
Trokas në portat e gjetheve
Një zog i vetmuar
Hynë mes baladave
dhe i këndon psalmet e Solomonit

Te flokët e erës
Bie një shi i verdhë
Kudo verdhësi në çarçafin e reve
Vetëm kalorësit e vetëtimave
Ngarendin pa pra
Si mjegullat në shalat e shiut

Si hije mali ecim rrugëve
Kalldrëmet me xhelozi të padëgjuar
I prekin çatitë
Nëpër parmakët e dritareve presin zogjtë
Ardhjen e një stine me shi
Ardhjen e zogjve pa pendla

THONË SE

Sonte është e hënë
Te muranat
Kungohen gurtë e murrmë
Duhet të ecim dhe t'i zgjasim duart
Përtej shpirtit të arkivoleve

Kjo poemë alegorike
Me qindra vjet drite eci
Duke i ndezur qirinjtë e pemëve
Te kopshtet e fshatit një mollë
Çdoherë i shkund frytet në këtë stinë

Ka kohë që frymëmarrja ime
Nuk kishte se çfarë tu bëjë qirinjve
Ajo vetë ndizej në vetvete
Thonë se
Përherë i përngjante pëllumbave vetëvrasës

Një hënë e zhveshur
Parakalonte nëpër kolonadat e yjeve
Asnjë meteor mbrëmë
Nuk i shkundi trishtimet nga xhepat e erës
Një yll i këputur nga sfondi i hapësirës
Qante te varret fatet e shirave

VIJNË DHE SËRISH KHEHEN

Sa herë që i hapim sytë
Ndryshojnë imazhet e ngjyrave
E verdha
Nuk është më e verdhë
Por ka një tjetër ngjyrë
Që nuk i përngjan asgjëje

Ky udhëtim nëpër vetveten time
S'ka asnjë rrugëdalje
Te çezma e xhamisë
Nuk xhindosen më plakat
Vetëm bucelat e drunjta
I shuajnë etjet
Në trungun e tharë të një peme

Sa herë që i hapim portat
Na vijnë mysafirët e paftuar
Trokasin dhe nuk ndalen erërat
Vijnë dhe sërish kthehen
Me trokëllimat e kuajve
Njerëzit endacak
Dhe ca hije të netëve sterrë

Prishtinë, 01 gusht 2013

PËRTEJ ÇDO MUNDËSIE

Këto fytyra
Të skalitura në mermer
Nuk paskan emër e as mbiemër
Heshtin si guri i zi
Edhe në rast se qajnë
Vaji i tyre u përngjan mjegullave

Poqë se i takojmë sërish te fjalët
Ky takim
Mbase ka një domethënie tjetër
Në fytyrat e ngrira të gurëve
Çelin ca lule të kristalta
Me një aromë të akullt prej mermeri

Kur ecin mes kolonadave
Kanë një lëvizje madhështore
Kokëlartë si mbretër
Që asnjëherë nuk abdikuan
Në sytë e tyre të ftohta çelë luledielli
Ashtu siç mugullon lulja e kripës

Këta njerëz prej guri
Me një shikim të mrrolshëm
Kanë një pamje të tejpashme
I shohin gjërat përtej çdo thellësie
Përtej çdo mundësie

DIKUR VONË KAH MBRËMJA

Këtu kur nga shtambat
Derdhet nata
Zogjtë e mendjes zbresin
Dhe pinë ujë në shpirtrat e degëve

Një fyell dëgjohet diku larg
Jashtë portave të mjegullta të erës
Nëpër rrugën e qumështit
Vijnë kalorësit e yjeve

Kur çelë agullima
Si zambakët në qytetin tim
Çelin edhe gjokset e vashave
Portat e mbyllura në mendjen e lumit
Për herë të parë hapen si fjalët

Dikur vonë kah mbrëmja
Kur kthehen edhe udhëtarët e fundit
Te Ura e Gurit disa zogj uji këndojnë
Dhe deri në nadje nuk ndalen serenatat

KY ËSHTË NJERIU

Ne të gjithë e dimë
Se kjo garë nuk ka fitues
Por sërish vrapojmë
Dhe asnjëherë nuk ndalemi
Për ta mbërri humbjen tonë

Një ditë takohemi me vetveten
Të lodhur dhe të sfilitur
Ecim me kokëfortësi
Deri te burimi
Por prapë se prapë
Jemi me humbjet e përditshme

Kjo ngjizje e humbjes dhe fitimit
Mbase jeton me njeriun
Kur papandehur takohemi
Me asgjësimin e fjalëve
Nuk di athua i përngjajmë vetvetes
Apo garës së filluar që në gjenezë

Ne të gjithë nganjëherë dhe çdo ditë
Vrapojmë si kuajt e egër
Nuk ndalemi as kur na i vënë mëgojëzat
Kjo është natyra e njeriut
Ky është njeriu

NGJYRAT

Nuk di a kanë gjërat ngjyra
Ose sytë tanë të mekur
Janë të ngjyrosur
Me ngjyrat e tejdukshme të fjalëve

Kjo mosdije e errët
Ose mosnjohje e sendeve
Po e vë në pikëpyetje
Metamorfozën e tejdukshme të ajrit

Sot jam i verdhë
Kurse ditën tjetër i zi si sterra
Cilat janë këto hije
Që e kapërdinë emrin tim

Një kalë i mrrolur
Mbase paska një ngjyrë të përhirtë
Ose vetë ngjyrat
Ndryshojnë formën e ekzistencës

Ngjyrat ah këto pamje të turbullta
Sa shumë po i përngjajnë njerëzve
Orë e çast ndryshojnë
Në pasqyrat konkave të shpirtit

NË TREGTARË ËNDRRASH

Të gjitha këto gjëra
Që po ndodhin dhe ndryshojnë
Në mesin tonë
Nuk mund të krahasohen
Me asgjë
E as me fluturimet e zogjve

Ne herë u përngjajmë mjegullave
E herë ëndrrave
Nëse ndodh që të zgjohemi vonë
E fajësojmë çarçafin e djersitur
Dhe kurrsesi vetveten

Ngjan që të shndërrohemi
Në tregtarë ëndrrash
Dhe që në fillim të gjumit
Në dhomën e fjetjes
I humbim zogjtë e mendjes

Gjërat që preken
Dhe ato që s'preken asnjëherë me gisht
Nuk di a janë pjesët e gjumit
Ose ato pjesë të ikura të ëndrrave
Që s'takohen
Asnjëherë me zhgjëndrrën e njeriut

JA KY ËSHTË QYTETI IM

Është e hënë
Një ditë e përmbushur me dashuri
Eci rrugëve të fëmijërisë
Dhe ndjehem
Ashtu siç ndjehet një perëndi

Me gishta të fishkura
Lehtë shumë lehtë
E ngacmoj të kaluarën
Nën Urën e Gurit i preki flluskat e ujit
Eci si një sovran kryelartë
Që kurrë nuk abdikojë

Si bandillin më njohin kalldrëmet
As qepenat
Nuk lënë pa më përshëndet
Kalaja disi më përcjellë me zili
Kah kaloj çarshisë përpjetë

Ja ky është qyteti im
I cili i njeh
Të gjitha udhët e fëmijërisë
Sa herë që gjezdisi përreth shatërvanit
Xhamat e dritareve
Akoma pëlcasin prej xhelozisë

SECILI PREJ NESH

Këto mure të akullta
Nuk kanë lidhje me prejardhjen time
As ky ishull i vdekur
Nuk ka asgjë të përbashkët me mua

Ne jemi larg njëri tjetrit
Sa që nuk mund të krahasohemi
Me asgjë që na rrethon

Secili prej nesh
I ka ëndrrat e veta
Të mbyllura
Ose të hapura në kujtesë

Bredhim rrugëve larg nga njerëzit
Na pengojnë nëse dashurojnë
Por edhe nëse urrejnë
S'munden me qenë me ne
Sepse nuk i përngjajmë askujt

Ndonjëherë jemi të zbrazët
U përngjajmë balonave fluturues
Kurse në disa raste
Mbushemi me urrejtje
Sa që shpërthejmë si flluskë sapuni

Secili prej nesh
I ka
Dhe më së miri i njeh ëndrrat e veta
I njeh rrugët kah ecën

Poqë se mbërrimë me i ndez qirinjtë
E mendjes
Do ecim deri te fundi i rrugës
E cila asnjëherë nuk përfundon

KJO LOJË POSA E FILLUAR

Nuk di
Por sonte jam mbyllur si guaca
Edhe ëndrrat i kam të mbyllura
Këto shikime të gurëzuara
Po i përngjajnë një ishulli
Braktisur nga njerëzit

Nuk i ndjej as duart e mia
Çfarë po ndodh
Me përrallën time të fëmijërisë
Bretkosa shndërrohet në mbretëreshë
Kurse mbretëresha në bretkosë

Kah janë duke fryrë këto erëra
Në mendjen time të zbrazur
Qenkan grisur dimrat e një stine
Ditët po i përngjajnë
Kristaleve të borës në saksi

Nuk di më mbase kam mbetur pa emër
Kur më thërrasin shirat
Më ngrihen gjymtyrët e trupit
Kjo lojë posa e filluar
Ndoshta asnjëherë nuk do të përfundoj

MBASE QANTE DRURI

Këto fytyra të lisave
Disi po i përngjajnë skulpturave
Prej mermeri
Sa i ftohtë ky gur në këtë mur
Sa të akullta duart e erës

Një lis i heshtur si një njeri
Vetmon me dimrin e kaluar
Në ashpërsinë e shpirtit të drurit
Zgjohet një tregim
I harruar nga njeriu i mirë

Frynte një erë e fortë
Nëpër të çarat e lisave si ulërimë
Dëgjoheshin disa zëra asnjanëse
Mbase qante druri
Ose ishte vaji i një guri të murrmë

Kaluan edhe disa ditë të brishta
Ne asnjëherë më nuk u këndellëm
Sërish po dëgjohen zërat e gurëve
Nga një furtunë e fortë
Po shkulen pjergullat e papjekura

Prishtinë, 03 gusht 2013

E VETMJA MOTËR E VËLLAIT

Pa asnjë njeri në rrugë
Depërtoj nëpër plasat e errësirës
Një heshtje e shurdhtë
Zvarritet kalldrëmeve
Eci në heshtje
Duke përjetuar fatin e gozhdëve

Duhma e kësaj lagështie
Po mi merr mendtë
Dhe si një zvarranik hynë pa trokitur
Nëpër portat e mbyllura të shpirtit
Atje te shelgjishtet e pikëlluara
Rënkon dhembja në shtratin e Gjergjit

E vetmja motër vëllait
I lanë fashat e trishtimeve të erës
Nëpër skutat e ngushta të mureve
Fshihen zërat e një kohe
Fshihen dhe askund nuk duken
Hukamat e plagëve të njerëzve pa emër

NËPËR RRUGËT E QYTETIT TË NGRIRË

S'di se si të depërtoj
Nëpër këto errësira të ngushta
Po më zihet fryma si këtyre degëve
Që vuajnë nga astma

Kjo duhmë e rënd
Mbase qenka e trëndafilave të kalbur
Po ma zë frymëmarrjen
Këlthas e bërtas
Si një zog i zënë në kurth

Trokas te portat e mëdha
Nuk hapen
As nga përbrenda
E as nga jashtë
Dëgjohet zëri asnjanës e një klithme
Heshtja e kalbur
Po i pllakos mendimet

Paskam mbetur si një gur i vetmuar
Asnjë zë sonte
Nuk depërton deri te lumi
Nëpër rrugët e qytetit të ngrirë
Bredhin qentë
Dhe endacakët e harruar prej njerëzve

SI DISA GJALLESA PARAHISTORIKE

Tjetërkush sonte jeton në mua
Me një pendël zogu
I shëroj plagët e mjegullave
Dhe pa zë në heshtje mortore
Kaloj rrugëve të fëmijërisë

Kaloj si të gjithë kalimtarët
Askush
Askënd nuk e njeh
Qepenat më duken
Si disa gjallesa parahistorike

Trokas në mendjen time
Kurrsesi të hapen dyert
Ku paskan mbetur miqtë e mi
E harruan njëri tjetrin
Ose ikën diku para kohe

Një pikëpyetje e madhe
Si një sfinë
Më është ngulur në rrashtën time
Kurse duart e mia skelet
Po u përngjajnë
Gjymtyrëve të të vdekurve

RRI VARUR SKELETI I ERËS

Ndodh që të ulem përballë pasqyrës
Dhe shikoj ekzistencën time
Në fund të filxhanit
Ai njeri atje në thellësi
Të një tejdukshmërie të paparë
Pa kurrfarë hezitimi
I zgërdhihet çdo kalimtari

Ky shikim i pandërprerë
Po i nervozon mushkonjat
Pas shpinës sime
Njeriu që i përngjan një eremiti
Po i prenë flokët
Dhe mustaqet e thinjura

Përbrenda kornizës së kalbur
Diçka nuk po funksionon
Sërish një njeri i huaj
Më bënë me dorë
Nuk di
Më thërret mua ose të kaluarën
Por dorën kurrsesi nuk e ndal

Sërish sot një njeri i panjohur
Trokiti në amalgamën e kujtesës
Jashtë mureve të lagështa
Rri varur skeleti i erës
Dhe një njeri sykaltër
Si qielli
Kundron me shumë vëmendje
Durimin mbinjerëzor

KJO UDHË E GJATË

Kur më nuk kemi se ku të shkelim
Do të ecim si somnambul
Mbi shkallët e verbëta
Të ecjeve tona të pafundme

Kjo udhë e gjatë
Që shtrihet përtej së kaluarës
E cila kurrë nuk përfundon
Një ditë do të zhytet
Si rosat e egra në shpirtin e mjegullave

Na domosdo nuk guxojmë të ndalemi
Duhet të ecim
Fundi i rrugës as që ekziston ndokund
Çdo hap i kaluar
Është një fitore mes gjetheve

Domosdo duhet të ecim
Nëse ngjan e kundërta
Nuk do të kemi më kohë ta arrimë
Njëherë e përgjithëson pafundësinë
E prekjes së yjeve endacak

E kur të mbërrimë
Poqë se mbërrimë ndonjëherë
Deri te përrallat tona
Do i pyesim shkurtabiqët
Për një fund që nuk ekziston

DAULLET ATË NATË

Çdo gjë ecën
Mandej edhe milingonat
Nuk kanë të ndalur në rrugën e qumështit
Ecin siç pështillet ajri i tymosur
Nëpër trarët e djegur të psalmeve

Dje mu kujtua se ishim te plepat
Kur filluan të vuajnë gjethet nga skleroza
Shiu i tepërt i zverdhi rrënjët
Dhe kurrë më nuk çelën lulet
Në syrin e trungut

Dolën edhe fëmijët e fshatit
Me i pritur dasmorët
Një grusht gur në sinorin e atdheut
S'kishim se ku të lëshojmë
Kudo kundërmonin kandrat e zeza

Akoma vazhdojnë të reshurat
Bien dhe nuk ndalen meteorët
Dasmorët dolën te varret e bardha
Daullet atë natë
Nuk pushuan deri vonë
Kur ia behu agullima
Fëmijët e përqafuan nusen

ATA QË U FLIJUAN PËR TY

Ata që u varrosen pa kryq
Pa hoxhë pa prift
Dhe gjysmëhënë
Janë djemtë më të denjë të kombit

Ata nuk deshën asgjë tjetër
Të marrin me vete
Mjaftonte vetëm hija e një shkoze
Dhe nderi i atdheut

Ata që hynë me dinjitet
Në shpirtra të mermerëve
Kurrë më
Dhe asnjëherë
Nuk e pranuan vdekjen

Ata që u flijuan për ty
O atdhe
Në ajrin tënd të kristaltë
U kemi ngritur
Përmendore amshimi

DHE HIJA E NJË DRURI

Sonte më duhet vetëm një ëndërr
T'i këpus nga ky pjergull
Blasfemitë e fëmijërisë
Ka ditë që kam ecur si i verbëti
Nëpër stërnishtat e kujtimeve

Veçse një ëndërr e lashtë
Më ka mbetur peng
Dhe hija e një druri
Që asnjëherë nuk lulëzoi
Kur më duheshin duart e tua

Sonte më duhet vetëm një tregim
Dhe ëndrra e një nate
Të cilën
Kurrë nuk e harrova

Po deshe ti shkundi mollët
Në kopshtin e mëkateve
Unë më nuk kam forcë
Për të iu kthyer ëndrrës së një nate
Që kurrë nuk e harrova

JE NJË PERI

Ti je burimi
Dhe shpresa e të përmbyturve
I drejtoj lutjet kah ti
Kur je duke ikur
I pyes zogjtë në fluturim
Askush nuk e di prejardhjen e mollës

Je grua apo nënë
Që me duart e tua të brishta
Përkund zërin e heshtur të zjarrit
I përkund
Djepat në ninullat e yjeve
Dhe asnjëherë nuk të bezdisin
Ikjet e meteorëve me bisht

Je lumi që gurgullon
Baladave të jetës
Ti je shtrati dhe bregu
I cili asnjëherë
Nuk takohen me trishtimin
Udhëtimet e tua janë të gjata
Dhe nuk kanë të sosur si lindjet

2.

Ti je grua
Je atdheu që kafshon
Je varri dhe djepi
Sa herë që hijet ndryshojnë
Në shpirtin tënd
Zgjerohen paralelet e mendimeve

Je burimi i lindjeve
Je një peri
Dhe do mbetesh e tillë
Deri në përsosmëri

DO TË VIJ DERI TE TI

Do të vij deri te ti
Në çastin kur të prekin duart e mia
S'do të jem unë
Por hija e një druri prej mishi

Ti nuk ke se për çfarë të frikësohesh
Nga zbrazëtira e kafkës sime
Sepse çdo gjë e zbrazët rrethon
Këtë vazo sferike
Të zbrazëta janë edhe shikimet e mia

Të thash se unë do të vij një ditë
Por nëse nuk kthehem
Me shijen e bukës
Dhe të mjegullave
Ti mos u merakos aq shumë

Këtu te ne
Dimrat janë të paparashikueshëm
Jemi mësuar të ziejmë
Lëvore drurësh kur na zihej fryma

Do të vij deri te ti
Nëse humbi mes këtyre rreshtave
Dhe nuk mund të më gjesh
Askund
E as nën hijen e rrapit

Ti më kërko në pluhurin e sinorëve
Ose nëpërmjet shpirtrave
Më kërko ku të duash
Por mos më kërko vetëm në Ferr

Prishtinë, 03 gusht 2013

Jashtë mureve të lagështisë

Cikli i tretë

ATË DITË NJË ARKIVOL I MBYLLUR

Sonte më duket gjithçka e largët
Të paprekshëm janë yjet
Në sfondin e kujtimeve
Vetëm një hije e bardh
Përkundet si lisi i tharë

Në këtë kohë
Gjethet nuk bëzajnë mes gishtave
Kaloi edhe treni i fundit
Pranë stërnishtave të kositura
Iku edhe vjeshta

Si duart e huaja
Mbetën duart e mia
Të fshehura diku në xhepat e erës
Nuk di vallë
A po i përngjaj drurit në kopsht
Ose portave të mbyllura

Kjo heshtje që më mbështjell
Me çarçafin e trishtimit
Paska ardhur këtu si arkivoli

Diçka e paqartë me pret
Në fund të rrugës
Si hutini zogun e plagosur

2.

Më kujtohet fare mirë e di
Kur si një pendël zogu
U lëshua në tokë gjethi i fundit
Stina rrinte e mrrolur
Dhe dëneste si kukuvajka

Nëpër të çarat e erës tmerrshëm
Fërshëllente furtuna
Fërshëllente
Një shpirt i nakatosur

Atë ditë një arkivol i mbyllur
Dhe i gozhduar
Me sfina prej dhembjeve
Bartej nga duart e plagosura të erës

SI ZGALEMAT E RRUFEVE

Vjeshta e paska veshur
Pallton e shqyer të dimrit
Mbase përgatitet për të ikur
Gjethet më në qytetin tim
Nuk u përngjajnë gjetheve
Qenkan zverdhur kokrrat e klorofilit

Nga frytet e pjekura
Rënduar janë pemët
Degët thyhen
Mollët dhe kumbullat
Puthen me tokën gratçore
Kurse nuset i kanë hapur krahët
Urishëm i përpinë
Edhe farat e fundit të kësaj stine

Një tjetër stinë e bardhë
Por me një vrazhdësi
Të paparë
Kundron si orli

Nga grykat e thepisura të Sharrit
Degët e lisave
Kanë filluar të thyhen nga acari
Acar edhe në shpirtra
Që ndjejnë ardhjen e marsit

Dhe shumë shpejt
Me një shpejtësi të padukshme
Si zgalemat e rrufeve
Erdhi edhe një Mars i çmendur

Atë çast Prishtina përjetoi
Kërcëllimat e rrotave të trenit
Menjëherë pas mesnate
Mbetën diku në jug
Edhe binarët e fundit të shpresave

NJË DHEMBJE SI KJO

Ka kohë që kam mbetur i verbët
Nga këto drita fosforeshente
Një hënë e kuqe te mjegullat
Shtrydh lotin e gurit

kam parë edhe herëve të tjera
Se si kallej toka ime
Kam shkelur zbathur si gjyshi im
Nëpër prushet e atdheut

Një dhembje si kjo
Nuk mund ta duroj guri
Pak shi
O vetëm pak shi
Duhet ta shuaj zjarrminë e këtyre etheve

Një dhembje si kjo
Nuk mund të durohet më
Ma prekni fytyrën e ngrirë
Nga ky prush që digjet në shpirt
Po shkrihen thonjtë e duarve të mia skelet

DILEMA

Nuk di cili prej nesh
Jeton brenda njëri tjetrit
Zgjati duart e tua të mjegullta
Përqafoje hënën
E portokalltë te ullishtat

Një tjetër diell
Po lind mbi kokën time të thinjur
A jam unë ti ose ti je unë
Këtë mund ta mësojmë
Nga pluhuri i kuq i arkivolit

Sa herë që ecëm me sy të mbyllur
Në drejtim të njëri tjetrit
Para nesh shfaqeshin si fantazma
Krakëllimat e sëmura
Të një dite që i përngjante
Korbave endacak

Preke fytyrën tënde
Në lotin e pasqyrës konvekse
Edhe ti do qash si asnjëherë më parë
Sepse zogjtë e ikur të mendjes
Sonte nuk ankorohen
Në asnjë lima

MËKATAT

I ndalëm orët e murit
Vetëm ato të diellit sonte punojnë
Nën kajsishte paska mbetur
Shumë pak mjegull
Ikën lypsarët
Me kalorësit e parë të mëngjesit

Ne pritëm një kohë të gjatë
Ishin të kota
Dyndjet e zogjve shtegtar
Vetëm hingëllimat e kuajve
Tregonin të tjerëve
Se nëpër këto shtëpi përdhese
Ende banojnë njerëzit

Lagjet i kishin harruar
Të gjitha predikimet dhe lutjet
Po ashtu edhe psalmet
Ishin diçka të huaj
Askush nuk i pranon si të vetat
Bredhin si zogjtë endacak
Nëpër shpirtra njerëzish

NË KOKËN TIME REBELE

Mos të hyjë më asnjë ëndërr
Në thellësinë
E syve të mi të gështenjta
Ti ishe ëndrra ime e parë
Dhe e fundit
Gjer sa i kalëroja mjegullat

Prej grykave të Sharrit
Me shekuj i dëgjonim
Këngët e shtojzovalleve

Pastaj nën flokët e tua
Të mëndafshta i shtruam
Të gjitha yjet e universit

Ti sërish mbete në kujtesë
Një yll i papërsëritshëm
Në kokën time rebele
Andaj nuk kam nevojë më
Për asnjë yll
Që ta krahasoj me ëndrrën time

PASTAJ VJEN HESHTJA

Netët nëpër shtëpia të vogla
Siç është kjo e imja
Janë shumë të ngushta
Të ngufasin si makthi i zi
Sa herë që marr frymë
Me shumë probleme
Hapen dritaret

Këto shtëpiza të vogla
Përpos zemrës
Kanë diçka tjetër të madhe
Ndoshta frikën
Ose vetë ekzistencën e dyshimit
Kur ajrosen lagështit e mureve
Nëpër dhoma futen disa lloje mizash

Pastaj vjen heshtja
Me gjasa është vëllai i makthit
Të zë për jake dhe nuk të lëshon
Me muaj të tëra
Ti mundohesh të ikësh
Por nuk të lëvizin
Këmbët e tua prej plumbi
Ngjizen për dyshemenë e akullt
Dhe shndërrohen
Në merimanga prej tmerri

AS ATJE E AS KËTU

As atje e as këtu
Por kudo shtrihen duart e lypsarëve
Shikimet e zbrazëta
Me përplot dhembje
Depërtojnë nëpër sytë e verbët
Të njerëzve

Kalojnë trotuareve mondanët
Duke u zgërdhirë me dashnoret
S'shohin asgjë
As duart e shtrira
Që verbojnë sytë e ajrit melankolik
Ecin pa kurrfarë qëllimi
Përballë një fantazme

Ecin thua se janë njerëz të mirë
Nëpër xhepat e mbushura
Me verdhushka
Tringëllojnë zërat e një egoizmi
Dhe nga të qeshurat
Harrojnë ekzistencën njerëzore

As atje e as këtu
Dhe asgjëkund
Nuk ndizen dritat e shpresave
Për skamnorët
Refreni Zoti të ndihmoftë
I përngjan përsëritjeve të njëtrajtshme
Të papagajve të verbët

MË SHKRUAJ NJË LETËR

Në çfarë do qoftë kohe
Ti më shkruaj
Një letër që frymon
E bardha
Nuk është përherë e bardhë
As e kaltra e kaltër

Ngjyrat ndryshojnë si njerëzit
Dhe sipas mendimeve
Sepse as guri nuk i përngjan gurit
Kur ndjen dhembje
Dhe kur qanë në duart e skulptorit

Të lutem
Më shkruaj thjeshtë një letër
Pa emocione
Ashtu siç njeriu
I shkruan mikut të vetë

Më kanë lodhur për së tepërmi
Këto letra elektronike
Që nuk kanë kurrfarë arome
Pa ngjyrë dhe shije
Shih sa është lodhur tastiera
Më shkruaj me dorë dhe shpirt

Prishtinë, 04 gusht 2013

POR AI BURRË

Më kujtohet fare mirë më kujtohet
Kur ti i ngjaje fluturës
Së larme nëpër fusha
Kaloje nëpër skenat e kuqe
Çdo gjë më dukej kuq
Si fustani yt i tejdukshëm

Në kraharor si burime ujërash
Gufonte shpirti i bareshës
Kurse zemra prej bilbili
Të rrihte si një daulle

Qeshjen e kishe fshehur si çdoherë
Te puthjet e këngës
Nën dërrasat e podiumit
Brohoriste masa
Prej miliona njerëzish

Rexhoja i madh
Me xhelozi e fshihte krenarinë
Nuk di askush
Athua vallë
Të dashuroj ty më shumë
Se këngën “Oj bareshë”

Por ai burrë
kishte një zemër të madhe
Për gruan e podiumeve
Dhe këngën që fluturonte
Nëpër shpirtin e plagosur të popullit

JASHTË MUREVE TË LAGËSHTISË

Një dru po ecën zbathur
Drejtë kujtimeve të gjetheve
Po ecën edhe një njeri i huaj
Ecën edhe vjeshta
Me një arkivol të verdhë
Askund asnjë degë e pathyer

Një trishtil me një pamje asnjanëse
Rri mbi një dunë prej trishtimi
Ri dhe i ledhaton
Me krahët e saja të thyera
Ajrin e tymosur të hanit
Që i përngjan
Pendlave të qullura të heshtjes

Kalon procesioni i vargjeve
Parakalojnë
Edhe disa lloje arkivolesh
Një zë si trishtimi i zogut
Dëgjohet përtej një varri të vetmuar
Jashtë mureve të lagështisë
Po ngufatet si një njeri
Vetmia e trishtuar e një zogu

NE BËHEMI ZOGJ TË EGËR

Kur nuk patëm se çfarë të bëjmë
Ecëm në dy kohë
Si në dy paralele të binarëve
I përjetuam makthet e ëndrrave

Një ditë bie një shi imcak
Kure ditën tjetër na pjekë dielli
Sa herë që na takohen shikimet
Te lulëzimet e manaferrave
Në bëhemi zogj të egër

Provojmë shijen e fluturimit
Na duken të hidhura
Thundrat e ditës
Një stinë e egër i shkund mollët
Kurse ajo tjetra
Merret me meremetimin e gjetheve

Kur s'na zë vendi vend
Bredhim si të huaj
Dhe vrapojmë qorrazi
Nëpër mendimet tona
Kur duhet t'i hapim portat
Shndërrohemi në heshtje
Si vazot e mbyllura të një vjeshte

FSHEHURAZI KAM HYRË

Me qindra herë
Ndoshta edhe më shumë
Desha të shkuli nga shpirti im
Një epitaf për të nesërmen

Por asgjë prej kësaj pune
Dikur vonë kuptova
Se unë s'di të shkruaj poezi

Kalova pranë mijëra varreve
Po aq herë me kokëfortësi
I lexova mbishkrimet e lashtësive

Por kurrë nuk mësova
Se si mund të shkruaj një poezi
E të mos qaj era
Fatin e zogut në fluturim

Fshehurazi kam hyrë
Edhe nëpër varret krishtere
Diku ndezja nga një cigare
E diku e qoja nga një gotë
Nëse jo për shpirtin e të vdekurit
Atëherë e pija
Për shëndetin dhe paaftësinë time

Prishtinë, 05 gusht 2013

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,* nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë ndërsa aktivitetin letrar e zhvillon në kuadrin e Klubit letrar "Fahri Fazliu", në Kastriot.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010

32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-
Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013

79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86**.”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87**.”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014

PËRMBAJTJA

Ky shpirti im pagan - cikli i parë 11
Si një varr i vetmuar 13
Përtej kujtesës 14
2. 15
Lëkura 16
Por ne do ecim 17
Një re e dendur 19
Një hënë e gjymtuar 20
Kur më zë kotësia 21
Po vdes një merimangë 23
Një ulërimë prej bishe 24
Një varkë e moçme 26
Lehin edhe yjet 27
Kjo natë 28
Si një hukamë deti 29
Në lotin e thyer të mëngjesit 30
Nëna ime moj loke 31
Miku im 33
Dy herë nga një e gjysmë 34
Më lërë më rehat 36
Kjo kohë 37
Nuk di a është dimër 38
Ky shpirti im pagan 39
Daullet e një nate - Cikli i dytë 41
Sonte do të ecim 43
te flokët e erës 44
Thonë se 45
Vijnë edhe sërish kthehen 46
Përtej çdo mundësie 47
Dikur vonë kah mbrëmja 48

Ky është njeriu 49
Ngjyrat 50
Në tregtarë ëndrrash 51
Ja ky është qyteti im 52
Secili prej nesh 53
Kjo lojë posa e filluar 55
Mbase qante druri 56
E vetmja motër e vëllait 57
Nëpër rrugët e qytetit të ngrirë 58
Si disa gjallesa parahistorike 59
Rri varur skeleti i erës 60
Kjo udhë e gjatë 62
Daullet atë natë 64
Ata që u flijuan për ty 65
Dhe hija e një druri 66
Je një njeri 67
2. 68
Do të vij deri te ti 69
Jashtë mureve të lagështisë - Cikli i tretë 71
Atë ditë një arkivol i mbyllur 73
2. 74
Si zgalemat e rrufeve 75
Një dhembje si kjo 77
Dilema 78
Mëkatet 79
Në kokën time rebele 80
Pastaj vjen heshtja 81
As atje e as këtu 82
Më shkruaj një letër 84
Por ai burrë 85
Jashtë mureve të lagështisë 87
Në bëhemi zogj të egër 88
fshehurazi kam hyrë 89

Botimin e këtij libri e financon
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT I KUVENDIT KOMUNAL-OBILIQ

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Daullet e një nate / Adem Zaplluzha.
- Kastriot : Shtëpia botuese " Fahri Fazliu" , 2014.
- 100 f. ; 21 cm.

Daullet e netëve kosovare / Baki Ymeri : f. 5- 9. - Adem Zaplluzha : f. 91-97

ISBN 978-9951-664-01-1